



Prishtinë, 02 maj 2013
Kodi i ZRRE-së: V_531_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenit 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe 2.16, Nenit 25 dhe Nenit 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPPEE-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së);
- Aplikacionin e KEK sh.a. të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike;
- Vendinim nr. V_519_2013 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik; dhe
- Kërkesen e datës 18 prill 2013 të KEK SH.A dorëzuar ZRRE-së për miratimin e tarifave të rregulluara me pakicë.

në seancën e mbajtur më 02 maj 2013 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHEN** tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar që do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 prill 2013.

ARSYETIM

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 18 prill 2013 ka pranuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK SH.A) kërkesen për shqyrtim të tarifave të rregulluara me pakicë;
 - Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj;
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KEK-ut, i nxjerrë me datë 19 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, i publikuar me datë 8 janar 2013;
 - Vlerësimi përfundimtar – Detajet mbi Operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe të furnizuesit publik, i publikuar me datë 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datë 22 shkurt 2013.
- II. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuar në hyrje dhe shqyrtimet të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



III. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 prill 2013 deri më 31 mars 2014, është si në tabelën e mëposhtme.

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të miratuara	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0-1	220kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		182.53	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		14.44	
		Energjia aktive (P)	€/kWh		2.23	
0-2	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		91.27	
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.09	6.09
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.07	2.09
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.94	1.72
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.07	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		6.33	6.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.39	3.20
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.91	2.88
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.99	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.45	5.45
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.28	3.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.46	3.36
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.81	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.17	3.17
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.20	5.11
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.80	4.82
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.72	0.72
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	11.33	7.33
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	13.64	8.94
			€/kWh	Tarifë e Ulët	6.82	4.46
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.05	3.63
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.54	1.81
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.00	5.01
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.51	2.51
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	10.16	7.27
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.07	3.65
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.27	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.51	3.22
			€/kWh	Tarifë e vetme	6.24	4.46
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	9.05	6.49
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		23.41	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		42.37	
		>600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		71.40	
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.18	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	9.17	9.17

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$



IV. I licencuari duhet t'i publikojë tarifat e miratuara nga Bordi i ZRRE-së.

V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjeje midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar